KËRKESË
Nr. 191/4, datë 2.6.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia e Tiranës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të ndërtimit të sistemimit dhe rikonstruksionit të infrastrukturës ndërmjet rrugëve "Stavri Themeli", "Babë Rexha" dhe "Ndre Mjeda" të qytetit, në Bashkinë e Tiranës është 583.380 (pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për sistemimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës ndërmjet rrugëve "Stavri Themeli", "Babë Rexha" dhe "Ndre Mjeda"

NR.	EMËR MBIEMËR	Zona Kadastr.	Nr. Pasurisë	Sip.Përgj. Truall /m²	Sip.Prekur Truall /m²	Çmimi në m²	Vlefta në lekë	Konfirmimi i ZVRPP
1	Artan Nuriu	8220	N - 7/212	28	28	20,835	583,380	Konf.nr.5732/1prot, dt/14.06.2012
						Shuma	583,380	